



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 752/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Afijete Sada Glllogijani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e paraqitur nga Ali Krasniqi, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Obiliq, kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.752/2021 i datës 03.11.2021, i paraqitur nga Ali Krasniqi, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Obiliq, kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 03.11.2021, ka pranuar apelin Anr.752/2021, nga Ali Krasniqi, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Obiliq, në të cilën pretendon se familjar të tyre po dëshmojnë se votat e tyre nuk kane dalur në këto vendvotime 1502E/01R, 1502E/02R, 1502E/03R, 1502E/04D, 1513E/01R.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi apelin, vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime të votave, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritet e ankuesit për të

marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit dhe mungesë të votave, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Ali Krasniqi, nga subjekti politik AAK, nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.752/21 më datë 05.11.2021

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaferr



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.